



Prishtinë, 30 tetor 2018
Kodi i ZRRE-së: V_1064_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.7, Neni 15 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.10 dhe nenin 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05 -L-084;
- Dispozitat e Nenit 20 të Ligjit për Energjinë Termike Nr. 05-L-052; dhe
- Amendamentin e Marrëveshjes për Furnizim me Ngrohje në mes të KEK Gjenerimi sh.a. dhe NQ Termokos sh.a , dorëzuar për aprovim ne ZRRE me datën 19 tetor 2018.

në seancën e mbajtur me datë 30 tetor 2018, nxori këtë:

VENDIM

1. **APROVOHET** Amendamenti i “Marrëveshjes për furnizim me ngrohje e lidhur me datën 24.12.2014, nr 252 “ në mes të KEK-Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. dhe NQ Termokos sh.a.

Arsyetim


1. Me datën 19 tetor 2018, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar Amendamentin e “Marrëveshjes për furnizim me ngrohje”, i cili është lidhur mes KEK sh.a. – NQ Termokos sh.a. me datë 17 tetor 2018.
2. Amendamenti i bashkangjitur i përmban 4 (katër) nene:
 - Neni 1, me te cilën zgjatet për 5 (pesë) vite periodha e vlefshmërisë se marrëveshjes –nga data e skadimit te marrëveshjes bazë gjerë me 15 tetor 2022; dhe
 - Neni 2, me te cilën ndryshohen 2(dy) paragrafët e Shtojcës IV te marrëveshjes bazë. Ky ndryshim është rrjedhoje e de-rregullimit te gjeneratorit te energjisë elektrike (KEK sh.a.). Konkretisht, çmimet e energjisë elektrike i referohen çmimit te furnizuesit te shërbimit universal (FSHU);
 - Neni 3, i cili shpreh pajtimin e palëve që pas çdo ndryshimi të çmimit të FSHU-së, kjo reflektohet me anë të një Aneks-marrëveshje; dhe
 - Neni 4, ku theksohet se të gjitha kushtet tjera të marrëveshjes bazë mbesin të pandryshuara dhe në fuqi.




3. Dispozitat tjera të marrëveshjes bazë e nënshkruar me datën 24 dhjetor 2014 dhe aprovuar nga ZRRE me datën 23 dhjetor 2014 me vendimin V_677_2014 mbeten në fuqi.
 4. Duke marr parasysh dispozitat ligjore të theksuara në hyrje dhe duke u bazuar në shqyrtimin e Amendamentit në fjalë, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d. Kryesues


Besim Sejfiqaj, Anëtar


Selman Hoti, Anëtar


Izet Rushiti, Anëtar